



# Qendrueshmeria – shiko lidhjet

(Resource ID: 332)

**Bardha Qirezi**

bardha.qirezi(at)gmail.com

This teaching resource is allocated to following University:

**RIINVEST – Riinvest College**

Institution:

**Riinvest College**

<http://www.sustainicum.at/sq/modules/view/332.Qendrueshmeria-shiko-lidhjet>



**Puna ne grup  
Plenium  
(mbledhje)**



**11 deri ne 30  
studente**



**Deri në 3 njësi  
leksionesh**



**Lidhja me Web  
e nevojshme**



**Anglisht, Shqip**

Burimi është përdorur si një parathenie për zhvillimin e qëndrueshem në të cilin çështjet globale dhe lokale të qëndrueshmërisë janë diskutuar. Ideja është adoptuar nga Kapitulli Ndergjegjesimi në librin "Vetja e qëndrueshme" Murray (2011). Burimi përdor gjithashtu metodën S.E.E the Link për të lehtësuar lidhjen e çështjeve të zhvillimit të qëndrueshem. Studentet do të shohin videon "Nena Toke" dhe do të vëzhgojnë 10 fotografi për të filluar diskutimin për çështjet e qëndrueshmërisë. Ata do të analizojnë perkufizime të ndryshme të qëndrueshmërisë për të konkluduar me një pohim të tyre për qëndrueshmërinë.

**Hapi 1:** Studentet do të shohin videon

“Nena Natyre”

dhe do te diskutojne per mesazhin qe ajo percjell

Ceshtjet e meposhtme mund te diskutohen:

Cili eshte mesazhi?

Cfare po ndodh?

Pse po ndodh?

Cfare mund te bejme?

**Hapi 2:** Ne pjesen tjeter studenteve do t'u tregohen shume foto te marra nga fotografi kosovar Arben Llapashtica .

Cdo foto do te diskutohet ne vecanti. Temat e diskutuara do te vendosen neper letra dhe ne to mund te perfshihen fjalet e meposhtme:

Shpyllezimi

Uje

Mbetje

Varferi

Papunesia e te rinjve

Ndotje

Deprivim social dhe shume te tjera

**Hapi 3:**

Keto jane kategorizuar ne tre shtylla te zhvillimit te qendrueshem: 1. Mjedisi ; 2. Shoqeria ; dhe 3. Ekonomia. 6 temat per cdo shtylle jane zgjedhur nga vezhgimi e diskutimi i fotove.

**Hapi 4:** Shiko ushtrimin e lidhjeve (shiko Metoda S.E.E Lidhjet faqe 104 ne Librin e Metodave ose lidhja ?????)

Studentet ndahen ne grupe me kater veta dhe jepen tre zarre te ngjyrave te ndryshme per t'i hedhur. Cdo ngjyre prezanton nje shtylle te zhvillimit te qendrueshem. Ne kete menyre ata zgjedhin nje aspekt per cdo shtylle dhe krijojne nje histori duke bere lidhjen midis tyre. Cdo grup prezanton historine.

**Hap 5:** mjaft perkufizime te qendrueshmerise do te jepen teks tudentet per t'u ripare dhe ata do te pyeten te theksojne fjalet kyce nga keto

perkuzizime qe kane kuptim per ta (Murray, 2011.loc 632). Duke perdorur keto fjale kyce, studentet do te krijojne nje perkufizim te individualizuar te qendrushmerise.

Fillimi i shprehjes se propozuar nga Murray do te perdoret:

Qendrushmeria per mua eshte .....

### **Hapi 6 (Kujdes! Ky hap do te kerkoje edhe 20 ore te tjera shtese se punes):**

Studenteve do t'u jepet nje detyre ne te cilen njera prej temave do te kerkohet me tej. Ne detyre, studentet do te nevojiten te intervistojne te pakten 3 pale interesi me qellim qe te prodhojne raportin. Keto mund te perfshijne banoret e zones, qeverine lokale dhe organet rregullatore, punen e OJQ-ve ne fushe, etj.

Ne raport studentet duhet te adresojne ceshtjet e nderlidhura si per shembull lidhjen midis stilit te jetes dhe sesi ndikohet natyra ose prodhimi i elektricitetit dhe ndotjes se ambjentit ose per shembull sesi vendimet ndikojne natyren per mire ose per keq, ose ceshtja e zgjidhjeve afatgjata dhe afatshkurtra.

---

## Mjetet e mësimdhënies



Video



Loje

## Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

Palet e interesit jane te integruara permes nje sere leksionesh:

- 1- Ngrohja globale
- 2 -Objektivat e Zhvillimit te Qendrushem
- 3- CSR
- 4- Zhvillimi njerezor

### Pika e forte

- Pika e forte e ketij burimi qendron ne lidhjen e zhvillimit te qendrushem me problemet reale ne Kosove

### Pika e dobët

- Mund të ekzistojnë probleme në sigurimin e aksesit për intervista

## Rezultatet e të mësuarit

- Të kuptojnë konceptin e qëndrueshmërisë, zhvillimit të qëndrueshem dhe tre shtyllave të zhvillimit të qëndrueshem.
- Të promovojnë të menduarin sistematik
- Të konceptojnë debatin global të qëndrueshmërisë me çështje konkrete të qëndrueshmërisë në Kosovë,
- Të krijojnë lidhje midis temave të qëndrueshmërisë
- Të shkruajnë një punë kërkimore dhe të prezantojnë çështjet e qëndrueshmërisë

## Lidhja për qëndrueshmëri

- Burimi prezanton qëndrueshmërinë dhe përfshin krieteret e mëposhtme të qëndrueshmërisë: mendim holistik ndër-disiplinor, të menduar sistematik, të menduar afatgjatë.

## Njohuri paraprake

Asnjë lloj njohurie paraprake specifike nuk kërkohet?

## Përpjekjet e përgatitjes

Mesatare

## Përshkrimi i përpjekjeve të përgatitjes

Fotografite duhet të zgjidhen me kujdes për të angazhuar studentet. Studenteve duhet t'u japin udhëzime të qarta sesi të shkruajnë fjale në letra dhe si t'i emertojnë ato.

## Aksesi

Free

## Gjykimi / vlerësimi

Vlerësimi varet sesi burimet janë përdorur si një njësi e vecante ose si pjesë e kurrikules.

Studenteve mund t'u kërkohet të përgatisin një prezantim në grup ose të shkruajnë një tekst kërkimor me jo më shumë se 1000 fjale për një temë të

zgjedhur,

Kriteret per secilen jane dhe nje informacionin per detyren.

Kriteret e pergjithshme te vleresimit do te adresojne:

- Aftesine per te bere lidhjet midis temave te qendrueshmerise
- Aftesite e te menduarit kritik ne shkrimin e detyres ose pergatitjes se prezantimit
- Evidenca e te lexuarit kritik ( tekste dhe artikuj te ndryshem)
- Evidenca e intervistimit te te pakten 3 paleve te interesit
- Perdorimi i citimeve te duhura, te referuara ne menyre korrekte dhe te drejteperdrejte ose perdorimi i fotove
- Konkluzionet e nxjerra ne pergjigje te pyetjeve te ngritura

## Kreditim/Çertifikatë

Detyra do te kete perqindje ne vleresimin total te modulit

## Financuar nga

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.